



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 31 Prot.

Tiranë, më 30/06/2020

**VENDIM**  
Nr. 16 datë 30.06.2020

**PËR**  
**SHPALLJEN E RIHAPJES SË APLIKIMEVE DHE PRANIMIN E**  
**DOKUMENTACIONIT PËR KANDIDATËT PËR ANËTARË TË SENATIT**  
**AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të nenit 19 të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", të Vendimin nr. 31, datë 17.3.2020 "Për përcaktimin e numrit të anëtarëve të Senatit Akademik të UMT-së sipas njësave kryesore", të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, Vendimit të KIZ nr. 8, datë 14.05.2020, të Urdhrit të MASR-së nr. 175, datë 30.6.2020 "Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Komisioni Institucional Zgjedhor në mbledhjen e datës 30.06.2020,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë rihapjen për aplikime për anëtarë të Senatit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (Personel Akademik dhe Student).
2. Aplikimet për Anëtar Senatit Akademik të UMT-së, rifillojnë në datë 01.07.2020 dhe përfundojnë me datë 05.07.2020. Dokumentacioni përkatës do të dorëzohet pranë KIZ-it në intervalin kohor 08.<sup>00</sup>-16.<sup>00</sup>
3. Kandidati duhet të paraqesë pranë KIZ-it të UMT-së, dokumentacionin sipas fletëve të aplikimit, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambjentet e UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR**  
**SILVANA BALA**

